



**20 VJET**

**UDHËTIM NË BESIM,  
SHPRESË DHE DASHURI**



**2003  
2023**



# Indeksi

|       |                                         |
|-------|-----------------------------------------|
| 3     | Një fjalë nga themeluesi & drejtori ynë |
| 4     | Udhëtimi ynë ndër vite                  |
| 5     | Fokusi ynë                              |
| 6-7   | Impakti ynë                             |
| 8-9   | Udhëtimi i tyre ndër vite               |
| 10-11 | Nga thyerja në plotësi                  |
| 12-13 | Kujtime                                 |
| 14    | Udhëtimi së bashku                      |
| 15    | Udhëtimi në të ardhmen                  |

## Alo! Mik

është një Organizatë Jo Fitimprurëse, e frymëzuar nga besimi i krishterë, për t'u shërbyer fëmijëve dhe familjeve në nevojë.

### Vizioni ynë

është të shohim fëmijët të lulëzojnë dhe të jenë aktorë ndryshimi në komunitetin e tyre.

### Misioni ynë

është t'u ofrojmë fëmijëve një përkujdesje jetë ndryshuese, duke sjellë sëbashku njerëzit në një udhëtim nga thyerja drejt plotësisë.

Alo ! Mik operon në Shqipëri që nga viti 2003, duke zbatuar projekte të ndryshme për të garantuar mirëqenien gjithëpërfshirëse të fëmijëve, veçanërisht për më të pambrojturit.



# Një fjalë nga themeluesi

Kush mund ta kishte menduar në vitin '99, që një 'vizitë' e thjeshtë në Shqipëri mund të transformohej në një udhëtim kaq pasionant? Kush mund ta kishte menduar që një ofrim ndihme e thjeshtë, e shtyrë nga urgjenca e krizës humanitare, mund të transformohej në një strategji afatgjat në favor të mijëra fëmijëve?

Por realisht, kush mund t'i rezistojë thirrjeve të një fëmije, apo zgjatjes së dorës së tij, apo ankthit e një fëmije që ka kuptuar se pa shkollim, e ardhmja e tij është e rrezikuar? Kush mund të heshtë në indiferencë para vuajtjes së një fëmije të braktisur?

Që nga regjistrimi i Fondacionit Alo ! Mik në 2003, hap pas hapi dhe vit pas viti, emocioni i parë u zëvendësua me një hartim global të një strategjie për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve në Shqipëri. Sot fëmijët përfitojnë nga një gamë e gjërë shërbimesh, nga programet e të mirëushqyerit deri tek terapitë e specializuara për Traumën në Fëmijëri.

Programet tona janë mjete të rëndësishme për të sjellë ndikim jetëndryshues. Gjithësesi, çelësi mbetet në kapacitet tona për t'i ofruar çdo fëmije një bashkëudhëtim në jetë, një ecje krahë për krahë – veçanërisht përgjatë stuhive të jetëve të tyre dhe në thyerjet e tyre. Për këtë arsye, ne synojmë t'i ofrojmë atyre fëmijëve dhuratën e të qenurit prezent me ta, duke qënë të vetëdijshëm që çdo udhëtim me secilin prej atyre fëmijëve është mrekullisht unike dhe e paparashikueshme.

Po, ne besojmë se fillimi i dashurisë, është që t'i lëmë ata që i duam të jenë vetvetja perfekte e tyre dhe jo të përpiqemi që t'i modelojmë sipas programeve tona apo të kuptuarit tonë. Përndryshe ne do të donim vetëm atë lloj reflektimi të veteve tona që do gjenim tek fëmijët. Por, aty ku ka hapësirë dhe përkushtim për të dhuruar një udhëtim të një dashurie të pakushtëzuar, jeta do të lulëzojë – madje edhe në mes të lëndimit dhe të thyerjes më të thellë. Skuadrat tona, Vendi i Kampit 'Eden Park', Qendra Komunitare 'OAZ' dhe Strehë Emergjente janë e re, janë vënde të tilla dashurie të përkujdesit.

Unë nuk mund të rri pa përmendur se 20 vitet e udhëtimit tonë janë një shprehje mirënjohjeje të thellë për kontributin e gjithësecilit prej jush: stafit, vullnetarëve, partnerëve në projektet tona, trajnerëve, donatorëve, institucioneve shtetërore dhe ata që kanë luftuar përkrah nesh në lutje të vazhdueshme. Çfarë gëzimi dhe çfarë privilegji kemi patur për të udhëtuar së bashku për të parë jetë të transformuara nga thyerja në plotësi, veçanërisht për ata më të papambrojturit!

Kontributi ynë modest i të 20 viteve të udhëtimit për hir të fëmijëve në Shqipëri është gjithashtu një thirrje Besimi, Shprese dhe Dashurie sipas Jezu Krishtit. Një udhëtim unik, në vetë hapat e një heroine shqiptare e njohur si e Krishtit, Nënë Tereza. Në të vërtetë, mobilizimi ynë i përbashkët i përgjigjet një thirrje shpirtërore: Të nderim jetë – edhe në vëndet më të errëta. *Jezusi tha : « Unë kam ardhur, që ata të kenë jetë, madje ta kenë me bollëk atë » Gjoni 10 :10.*


**Sylvain Vergnon**





# UDHËTIMI YNË NDËR VITE

## VËSHTRIM I SHPEJTË







## Fëmijët & Familjet në nevojë

Pavarësisht progresit të madh gjatë dy dekadave të fundit, shumë familje akoma jetojnë në situata të pasigurta dhe po luftojnë për të siguruar një mirëqenie minimale. Prandaj kujdesemi dhe fuqizojmë fëmijët dhe familjet nëpërmjet ndërhyrjeve të drejtpërdrejta dhe gjithëpërfshirëse.

### Mbrojtja e Fëmijëve

Është detyra jonë t'i mbajmë fëmijët të sigurt, të promovojmë mirëqenien e tyre dhe t'i mbrojmë nga format e ndryshme të abuzimit dhe dëmtimit.

### Zhvillimi i Besimit

Vëmendja ndaj zhvillimit të besimit duhet të shkojë paralelisht me të gjitha aspektet e tjera të zhvillimit (Dan Brewster). Kërkimet tregojnë, se nëse zhvillimit shpirtëror i kushtohet rëndësia dhe vëmendja që meriton, sjell një kontribut pozitiv në jetën dhe zhvillimin e fëmijëve.



## Trauma & Kriza

Trauma në fëmijërinë nuk është e rrallë dhe ndikon gjithçka — aftësinë e një personi për të mësuar, për të menaxhuar emocionet dhe sjelljen, shëndetin, marrëdhëniet, etj...

Prandaj ndërtojmë ndërhyrje për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur çështjes së traumave komplekse të marrëdhënieve në fëmijëri, duke ofruar kujdes dhe shërbime të specializuara dhe duke mobilizuar dhe pajisur punonjësit dhe profesionistët

## Dhuna në Familje

Dhuna në familje është një çështje që prek të gjitha sferat e shoqërisë.

Për t'i dhënë fund këtij fenomeni dhe për të mbështetur viktimat, i gjithë komuniteti duhet të ngrihet dhe të punojë së bashku.





## OPERATION CHRISTMAS CHILD

nga Samaritan's Purse



**354'720 dhurata**

Shpërndarja e dhuratave të Krishtlindjes për të demonstruar dashurinë e Zotit në mënyrë të prekshme për fëmijët në nevojë në mbarë Shqipërinë, në partneritet me kishën lokale.


## TEATRI



**18'858 fëmijë**

Shfaqje interaktive 1- orëshe të cilët përfshijnë dramatizime, kërcime, këngë, lojëra dhe kukulla.

## KIDSGAMES



**4'119 fëmijë**  
**46 fshatra/qytete**

Kamp ditor bazuar mbi modelin e lojërave olimpike për fëmijët e moshës 6-14 vjeç, në bashkëpunim me Kishat lokale.



## KAMPE NË EDEN PARK

**8'982 fëmijë**  
**& adoleshent**

Kampe rezidenciale për fëmijët & të rinjtë me fokus përjetime shpresëdhënëse duke mbështetur zhvillimin edukativ, social dhe shpirtëror të kampistëve.





## FUQIZIMI I FAMILJEVE NË NEVOJË

**55** fëmijë  
të fuqizuar

**217** familje  
të mbështetura në kohe krize

**65** familje të mbështetura në afatgjatë &  
me shërbime të integruara


Mbështetje praktike, psiko-sociale & shpirtërore,  
si dhe ofrim i shërbimeve të integruara  
për fëmijët dhe familjet.



## TRAJNIME

**2'427** persona

Trajnime me tematika të ndryshme:  
*mbrojtja e fëmijëve,*  
*kampe ditore dhe rezidenciale,*  
*shërbesa e fëmijëve në Kishë,*  
*përkujdesje e informuar ndaj traumës,*  
për ata që punojnë me fëmijët.







# UDHËTIMI I TYRE NDËR VITE

## Mariela

Unë jam Mariela, 27 vjeçe, nga Tirana. Familja ime përbëhet nga bashkëshorti, mamaja, vëllai dhe mbesa ime. Kam mbaruar studimet për Asistente Administrative. Më pëlqen muzika, sporti dhe udhëtimet. Dëshira ime më e madhe është që t'u jem afër dhe të kujdesem për personat me zemër të thyer. Të bëj atë që të tjerët kanë bërë për mua.

Fëmijëria ime ka qenë e bukur por edhe shumë e vështirë në të njëjtën kohë. Në fëmijëri mami është kujdesur nga larg për mua, por shumë rrallë mund të jetoja një ditë të vetme me të, pasi jam rritur në një Qendër Rezidenciale. Pjesën më të madhe të kohës kam qenë e rrethuar me shumë persona, por në fakt ndihesha e vetmuar dhe me dhjetëra pikëpyetje për jetën time. Kush jam? Çfarë të ardhme do të kem? A do t'ia dal ndonjëherë në jetë? A do të kem punë apo familje? ... Kishte rrënjë të thella dëshpërimi në jetën time. Kisha shumë frikë të përballesh me realitetin.

Ajo që me frikësonte më tepër ishte mungesa e një marrëdhënie me mamën dhe problemet me shëndetin e saj. Edhe pas rikthimit përgjithnjë tek ajo (18 vjeçe e ne vazhdim), sfidat në jetën time kanë qenë të panumërta, sidomos me shëndetin e saj. Kjo për mua ishte sikur të prekja fundin në çdo aspekt të jetës.

I jam mirënjohëse Zotit që përgjatë këtij udhëtimi të vështirë, Ai ka sjellë njerëz në jetën time që më kanë ndihmuar të gjej veten dhe shpresën për të ardhmen. Në këtë udhëtim, Zoti solli në jetën time Alo ! Mik (Silvanin dhe Ruthin). Kontakti im i parë me ta ka qenë në moshën 7 vjeçe. Në moshën 11 vjeç e në vazhdim krijova një marrëdhënie edhe më të ngushtë me Ruthin dhe Silvanin, kjo falë aktiviteteve ku isha përfshirë me kampet verore, me grupin e fëmijëve dhe të rinjtë, si dhe me punën vullnetare në kampe verore.

Alo ! Mik ka qenë për mua një mbështetje e madhe veçanërisht në periudhën më të vështirë, kur kisha nevojë për të qenë financiarisht e pavarur dhe për të ndihmuar familjen time. Kam kërkuar ndihmën e Silvanit dhe Ruthit për një mundësi punësimi, dhe përgjigja e tyre pozitive ka ndryshuar rrjedhën e jetës dhe ka ndezur një shkëndijë shprese për mua.

Për 7 vite kam qenë punonjëse e Alo ! Mik. Aty kam pasur mundësinë të rritem profesionalisht, të trajnohem dhe të sfidoj veten në pozicione të ndryshme. Kam pasur mundësinë e trajnimeve profesionale mbi metodologjitë e kujdesit të fëmijëve. Me ka mësuar mënyrat se si duhen trajtuar fëmijët në kontekste të vështira. Aty kam marrë një përvojë të çmuar jo vetëm pune, por edhe vlerash që ka kjo organizatë.

Ka dy vite që tashmë jam punësuar në një tjetër organizatë që punon me fëmijët në nevojë, duke ofruar shërbime të ndryshme dhe duke ndarë lajmim e mirë të Ungjillit me ta. Udhëtimi im profesional dhe personal me Alo ! Mik, më ndihmon në punën dhe shërbesën me fëmijët.

Alo ! Mik ka qenë për mua një derë e hapur, një mundësi për t'u ndërtuar, rritur dhe njohur veten. Sot kam gëzimin dhe ajo që më motivon është të pasurit shpresë për të nesërmen. Dhe mbi të gjitha, burimi im i gëzimit është ngushëllimi tek Jezus Krishti.



## Greis

Unë jam Greisi, 16 vjeçe. Me pëlqen sporti, veçanërisht volejbolli. Jetoj me familjen time, mamanë, babain, dy motrat dhe dy vëllezërit. Gëzimi im më i madh që kam në jetë është familja ime. Këtë vit filloj shkollën e mesme.

Alo ! Mik ka qenë një bekim i jashtëzakonshëm për mua dhe familjen time. Pa Alo ! Mik as unë e as familja ime nuk do ishim këtu as këta që jemi sot.

Deri në moshën 7 vjeçe, unë së bashku me familjen kemi jetuar në Sharrë. Situata atje është e mjerueshme. Njerëzit jetonin në baraka ku çdo gjë që bie jashtë futet edhe brenda. Ne nuk kishim ujë të laheshim, ushqim të hanim dhe rroba të vishnim. Babi dhe mami punonin tek plehrat e Sharrës duke shitur mbeturina për të na ushqyer ne. Si unë jetonin edhe dhjetëra familje të tjera. Ditët tona gdhieshin dhe ngryseshin në mes të plehrave, mjerimit dhe mungesës së shpresës.

Aty ku jetonim ne, nga njëra anë e rrugës mblidheshin bidona dhe kanaçe dhe në anën tjetër e saj shiteshin ato. Kjo ishte rutina e përditshme. Ne fëmijët luanim aty në rrugë mes plehrave dhe barakave. Gëzimet tona të vogla ishin kur prindërit gjenin ndonjë lodër në plehra dhe na e sillnin që të luanim me të. Jeta ime dhe e familjes sime mori një rrjedhë tjetër kur unë isha 7 vjeçe. Alo! Mik erdhi në lagjen tonë. Na mblodhën rreth vetes ne fëmijët dhe më pas biseduan me prindërit tanë për të na regjistruar në shkollë. Ata na blenë rroba, çanta e mjete shkollore, mua e shumë fëmijëve të lagjes sime. Shkolla ishte shumë larg dhe Alo ! Mik na çonte me fugon në shkollë, sidomos në ditët me shi.

Shkolla është pikënisja që më solli tek kjo që jam sot, ndryshe nga shumë moshatare të miat që janë martuar që 12 vjeçe. Nuk ka qenë gjithnjë e lehtë për mua, pasi për shkak të kushteve familjare jam detyruar të punoj në moshën 11 deri në 13 vjeçe në një hotel në Durrës. Ky ka qenë një moment delikat, pasi po rrezikoja shkollën, ndaj vendosa ta lë punën dhe t'i përkushtohesha shkollës. Familja më mbështeti, sidomos mami. Ajo na nxit që të vazhdojmë shkollën, pasi ajo vetë nuk ka pasur mundësi të shkollohet.

Gjithashtu, në 2016 Alo ! Mik na mbështeti që të zhvendoseshim në Kombinat, në një shtëpi me qera. Kjo ishte një jetë e re për ne. Na dukej vetja në ëndërr. Gjithçka na dukej e bukur, muret, dritaret, mobilitet. Edhe babai im nuk kishte nevojë të punonte më në plehra për të siguruar jetesën tonë. Ai filloi punë si usta në ndërtim.

Vite me radhë jam përfshirë tek programet e OAZ, që më kanë ndihmuar me mësimet, jam argëtuar dhe jam përfshirë në shumë aktivitete të cilat më kanë ndihmuar në ecjen time në shkollë dhe në jetë. Aty ne bënim detyrat, hanim drekën, merrnim pjesë në aktivitete dhe luanim me njëri – tjetrin. Kujtime fantastike kam edhe nga kampet verore që kam marrë pjesë. Kur je në kamp veror e harron realitetin, futesh në një botë të bukur si në ëndrra. Mund të them që në këto kampe ndihesha e plotë, pasi merrja shumë përkujdesje dhe dashuri.

Kjo është arsyeja pse unë këtë vit (2023) kam vendosur të shërbej si vullnetare tek Eden Park, duke ndihmuar stafin me punë të ndryshme. Atë që kam marrë dua ta jap për ata qindra fëmijë të tjerë që ashtu si unë në këtë kamp të përjetojnë dashuri e përkujdesje. Alo ! Mik është bekim nga Zoti për mua dhe familjen time.

Ëndrra ime më e madhe është të mbaroj shkollën, universitetin dhe të behëm dikush në jetë. Dua të kem një punë të mirë, jo vetëm për veten time, por që të ndihmoj familjen, motrat dhe vëllezërit, që ata të gjithë të shkollohen dhe të kenë një jetë të mirë.

## Arlinda

Unë quhem Arlinda, jam 24 vjeçe, jam vajza e madhe e familjes. Kam një vëlla dhe dy prindër të mrekullueshëm. Pasionet e mia kanë qenë modelingu, televizioni, por tani e gjej veten ndërmjet artit dhe shkencës. Jam diplomuar për inxhinieri softuerike dhe pas fakultetit mora një hap të bëja një shkollë biblike.

Udhëtimi im gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës ka qenë plot sfida për shkak të paragjykitimit dhe bullizimit. Fjalët “maloke”, “stekë bilardo”, “stikadent dhembesh”, “slims” etj. më përdoqën deri në gjimnaz. Duke i dëgjuar vazhdimisht e pranova bullizmin dhe vazhdova të besoja që ashtu jam. U mbylla në vetvete dhe qaja me orë të tëra pasi nuk ndihesha e pranuar në shoqëri.

Në 2010-11 u përfshiva në programin e Alo ! Mik “Kids Games” që mbeti në zemrën time. Njerëzit shërbenin me gjithë zemër. Aty pata mundësi të mësoj shumë rreth besimit. Programe të tilla për mua kanë qenë bekim dhe rritje nga ana fizike dhe shpirtërore. Më kanë ndihmuar ta shoh veten dhe të tjerët me dashuri, ta pranoj dhe ta dua veten siç jam, dhe mbi të gjitha të besoj që jam krijuar në mënyrë të mrekullueshme.

Dhe duke pasur kaq kujtime të bukura dhe një ndikim pozitiv në jetën time, në vitin 2015 e deri më sot shërbej si vullnetare gjatë verës në kampet verore që organizohen nga Alo ! Mik në Eden Park.

Dua që atë që përjetova unë me programet e Alo ! Mik, ta përjetojnë edhe fëmijët e tjerë. Është një motiv i jashtëzakonshëm për mua pasi aty shoh fëmijë të etur për dashuri, për një njeri të besueshëm, për një fjalë inkurajimi dhe për Zotin. Fëmijët zakonisht nuk duan të largohen nga kampi, pasi aty ndihen të sigurt, të mbrojtur, të dashur, të gëzuar të pranuar.

Lotët e fëmijëve në fund të kampit dhe transformimi i tyre përgjatë ditëve të qëndrimit aty janë një thesar i paçmuar për mua.

Lutem që përmes meje dhe punës së Alo ! Mik këta fëmijë të jetojnë jetën në plotësi dhe të përjetojnë dashurinë e Perëndisë.





# NGA THYERJA NË PLOTËSI

Në një botë që është thellësisht e thyer, fëmijët janë të ekspozuar ndaj shumë faktorëve të rrezikut - varfëria, abuzimi, neglizhenca, bullizmi, mosfunksionimi i familjes dhe më shumë. Ne e dimë se këta faktorë rreziku kërcënojnë zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve tanë. Ne bëjmë gjithçka që kemi në dorë për t'i mbrojtur ata. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve tona më të mira, bota vazhdon të jetë një vend i thyer dhe i rrezikshëm për shumë fëmijë.



Ndërsa bëhemi më të vetëdijshëm për kërcënimet me të cilat përballen fëmijët për mirëqenien e tyre, jemi gjithashtu më të vetëdijshëm për rolin jetësor që luan rezilienca. Rezilienca është aftësia e fëmijëve për t'u ngritur prapë pas vështirësive dhe për të kapërcyer rrethanat e vështira të jetës. Shumë faktorë kontribuojnë në reziliencën e fëmijëve; megjithatë, një faktor pozitiv befasues është aspekti shpirtëror i fëmijëve.

Të gjithë fëmijët janë qenie shpirtërore. Ata shprehin karakteristika shpirtërore të kuriozitetit, habisë, frikës, varësisë dhe besimit ndërsa ndërveprojnë me botën përreth tyre. Edhe fëmijët shumë të vegjël bëjnë pyetje të mëdha shpirtërore: Nga kam ardhur? Kush jam unë? A kujdeset dikush për mua? Si mund ta di se çfarë është e drejtë dhe e gabuar? Si rezultat, puna e vërtetë e zhvillimit gjithëpërfshirës me fëmijët duhet të përfshijë gjithmonë zhvillimin e tyre shpirtëror.



Si të krishterë, ne besojmë se të ndihmosh fëmijët të zhvillojnë një marrëdhënie personale me Perëndinë e Biblës është thelbi për t'i ndihmuar ata të rriten të shëndetshëm dhe të plotë. Gjithashtu, studime të shumta kërkimore tregojnë se marrëdhëniet e fëmijëve me Perëndinë mund të ndihmojnë gjithashtu për t'i mbrojtur ata përballë fatkeqësive. Këto studime tregojnë se përvoja e një fëmije në praninë e Perëndisë mund t'u ofrojë atyre rehati dhe paqe në mes të vështirësive. Këto studime po ashtu sugjerojnë se historia e Perëndisë mund t'i ndihmojë fëmijët të kuptojnë botën dhe vuajtjet, pasi ofron përgjigje koherente për pyetjet shpirtërore të fëmijëve dhe i ndihmon ata të kuptojnë historitë e tyre.

Faktkeqësisht, bota ka qenë gjithmonë një vend i vështirë për fëmijët dhe Bibla është shumë e sinkertë për këtë. Shumë nga fëmijët që takojmë në faqet e Biblës u formësuan nga një botë e thyer, duke përfshirë Moisiun, Miriamin, Jozefin, Samuelin, shërbëtoreshen e Naamanit, Josian, Danielin dhe Esterin. Këta fëmijë, dhe shumë si ata, përjetuan skllavërinë, gjenocidin, luftën, korrupsionin, shpërbërjen e familjes, rrëmbimin, dhunën dhe më shumë. Megjithatë, në secilin prej këtyre shembujve, Perëndia jo vetëm që ka siguruar për fëmijën, por e ftoi atë të bashkohej me Të për të sjellë plotësinë brenda botëve të tyre të thyera.

Kur fëmijëve u jepet mundësia për të eksploruar aspektet shpirtërore të personalitetit dhe për të kërkuar përgjigje për pyetjet e tyre më të thella të zemrës, aspekti shpirtëror forcohet dhe po ashtu edhe reziliencia e tyre.

Esther L. Zimmerman, PhD, Associate Chair—Undergraduate  
*Lancaster Bible College*







“Ndihemi shumë rehat kur flasim me ju, sikur të ishim familje së bashku.”

L. S., nëna e 4 fëmijëve – përfituese e OAZ

“Qendra OAZ është ‘Heroi im’ sepse stafi në qendër kujdeset për mua, më siguron ushqim dhe më mbështet në detyra/aktivitete. Ata janë edhe mbrojtës për mua, sepse kur kam ndonjë problem në shkollë, janë gjithmonë të gatshëm të përgjigjen dhe të ndërhyjnë. Kështu që nuk ndihem vetëm. Prandaj e quaj ‘Heroi im’.”

B. S., 10 vjeçe – përfituese OAZ

“Jam shumë e lumtur dhe mirënjohëse që mund të vazhdoj shkollën e mesme.”

S.S., 15 vjeçe – përfituese OAZ

“

Jemi zhvendosur në shtëpinë e re pas shumë vitesh jetese në kushte ekstremisht të vështira. Tani në shtëpinë e re ndihemi shumë mirë. Mund të shkojmë në shkollë me rroba të pastra dhe flemë shumë të qeta.”

S. L., 12 vjeçe – përfituese OAZ

“

Kur kam ardhur në fondacionin Alo! Mík, kam qenë 8 vjeçe. Ne fillim isha e ndrojtur por më pas u mësova. Bëra shumë shokë e shoqe që më respektonin dhe më donin. Aty u miqësova dhe me stafin, të cilët më ofronin dashuri. Unë jam shumë e kënaqur që jam pjesë e fondacionit Alo! Mík. Aty bëjmë detyrat, luajmë, organizojmë aktivitete, hamë mëngjesin dhe dreken. Kam pothuajse 3 vite që jam pjesë e fondacionit Alo! Mík. Dashurinë që më kanë dhënë shokët, shoqet, mamí dhe stafi s'ma ka dhënë askush deri me sot.

”

N. S., 11 vjeçe – përfituesi OAZ



“

Fondacioni Alo ! Mík më dha një mundësi për të vazhduar përpara,  
të shkollohem dhe të kem shumë miq.  
Gjithashtu, përmes tyre u njoha me Perëndinë. Alo ! Mík  
tashmë është pjesë e familjes sime.  
Kjo gjë më ka kthyer ëndrrat e mia në realitet.  
Jam mirënjohëse për të gjithë ata që më kanë ndihmuar.

”

A. Sh, 17 vjeçe – përfituese OAZ

“

Unë personalisht kam 2 vite që shërbej si vullnetare në Alo ! Mík dhe për  
mua ka qenë një eksperiencë që më ka nritur shumë nga ana shpirtërore  
dhe në praktikë. Gjithashtu aty kam gjetur një kujdes të veçantë edhe nga  
secili staf/punonjës, duke më mirëpritur jo vetëm mua por çdo vullnetar  
tjetër. Ata janë kujdesur për gjithçka që na duhej ne.

”

Melsi – vullnetare në Eden Park

“

Shumë mirënjohëse Perëndisë për zemrën e gjithsecilit për të  
shërbyer në një punë kaq të bukur, duke e bërë me durim, me  
dashuri, me gëzim, pa u lodhur  
dhe pa u ankuar.  
Zoti ju bekoftë shumë!

”

Vila – pjesëmarrëse në kampin e adhurimit në Eden Park

“

Zot! Falemínderit shumë që kujdesesh për ne çdo dite nga lart! Falemínderit  
që na mundësove këtë kamp në të cilin kam njohur shumë shokë e shoqe.  
Falemínderit që je me ne çdo ditë. Falemínderit që gëzohesh me ne.  
Falemínderit që hidhërohesh me ne, që na ngushëllon në momente kur kemi  
nevojë për ty...falemínderit që na mbështet në çdo hap të jetës sonë...  
dhe falemínderit për mijëra gjëra të tjera që ke bërë për ne.  
Zot, lutem që familja ime, miqtë e mi, personat e tjerë që kam  
për zemër të jenë mirë!

”

Pjesëmarrëse në kamp, Eden Park

“

Jam falënderuese për mundësinë që më është dhënë dhe shumë e lumtur  
që çdo gjë shkoí ashtu siç duhet. Kam ndjerë mikepritje dhe mirënjohje  
nga të gjithë. Shpresoj që tërë përkujdesjen dhe dashurinë që mora ta kem  
përcjellë edhe tek fëmijët. Kanë qenë ata tek të cilët kam gjetur motivim,  
frymëzim për të vazhduar përpara edhe kur ndihesha e lodhur.

”

Ana – staf sezonal në Eden Park

“

E lumtur që kam pasur mundësinë t'u shërbej më shumë se 1000 fëmijëve  
nëpër kampet që ky fondacion ka organizuar. Perëndia ka vepruar fuqishëm  
në ato kampe si për fëmijët ashtu dhe për stafin.  
E bekuar që kam krijuar miqësi të reja dhe që kam njohur  
Ruthin dhe Silvanin, të cilët jo vetëm që kishin një kujdes të veçantë  
ndaj fëmijëve por edhe ndaj stafit. Inkurajohem  
nga zemra që ata kanë pasur dhe kanë për fëmijët.  
Jam e emocionuar të shoh se ku do të jetë Alo ! Mík edhe pas 20 viteve të tjera.  
Lutem që Perëndia të lartësohet akoma dhe më shumë.

”

Arsea – vullnetare në Eden Park





Grain of Wheat  
INTERNATIONAL

# UDHËTIMI SË BASHKU NJË FJALË NGA PARTNERËT



Kur dëgjoj për Alo ! Mik, më rikthehen disa imazhe. Së pari Silvani & Ruthi të cilët së bashku marrin këtë thirrje për të shkuar në Shqipëri për t'u kujdesur për fëmijët e rrugës dhe veçanërisht për ata që jetojnë në landfillin e Sharrës. Zemra ime është prekur kur shoh dashurinë e tyre për fëmijët që askush nuk dëshiron t'i ndihmojë, për familjet që shpesh përçmohen. Veprimet e tyre gradualisht i kanë treguar fëmijëve se ekziston një Zot që i do.

Pastaj dëshira për të pasur një zyrë për skuadrën e tyre dhe një tokë jashtë qytetit për të ndërtuar një kamp për fëmijët. Vizioni është i gjerë, nuk është vetëm për të ftuar fëmijët të lënë pas dore, por edhe për t'u shërbyer Kishave. Për t'i ndihmuar të gjithë të zbulojnë bukurinë e natyrës dhe të mësojnë të lavdërojnë Zotin.

Sylvain dhe Ruth janë vizionarë dhe pionierë, ata nuk i shmangen asnjë sfide, por refuzojnë të punojnë pa një skuadrë. Është për skuadrën e tyre bashkë me ta që i shpreh urimet e mia për këtë 20-vjetor të mrekullueshëm të Alo ! Mik.

Anne-Christine Bataillard, ish President Ndërkombëtar (2000-2015)

*Grain of Wheat International*

Urime 20 vjetori i Shërbesës së Alo Mik në Shqipëri.

Faleminderit Silvanit & Ruthit dhe të gjithë partnerëve të Alo ! Mik për përkushtimin tuaj për të parë fëmijët të lulëzojnë dhe për qenë agentë ndryshimi në komunitetin e tyre. Jemi të bekuar të dëshmojmë shërbesën afatgjatë që ju dhe bashkëpunëtorët tuaj keni dhënë, duke punuar në një nivel të thellë me shumë familje dhe fëmijë për shumë vite.

Falë besnikërisë së Zotit, jeta e shumë njerëzve është ndikuar, pasi 20 vite është një kohë që i gjithë brezi të rritet dhe të jetë një bekim për bashkëmoshatarët, familjet dhe brezat e ardhshëm.

Faleminderit për përkushtimin dhe zemrën tuaj shërbëtore dhe ju falënderoj për kontributin tuaj në Botën pa Jetimë në Evropë dhe për të parë fëmijë të lulëzojnë, familje të forta dhe Kisha të angazhuara.

Richard Procter – WWO Europe  
Lubo Hlavacka – WWO Global



Bashkëpunimi i suksesshëm mes World Vision Albania dhe Fondacionit Alo! Mik është një histori frymëzuese e përkushtimit të përbashkët në ndihmë të fëmijëve në nevojë.

Që prej vitit 2012, nëpërmjet organizimit të kampeve verore dhe aktiviteteve të tjera, ky bashkëpunim ka ofruar mundësi të shumta për më shumë se 3000 fëmijë për të marrë pjesë në aktivitete ku edukimi dhe argëtimi janë përmbledhur në një përvojë të paharrueshme për ta.

Vetëm në vitin 2023, 480 fëmijë dhe adoleshentë patën mundësinë për të zhvilluar aftësitë e tyre personale, për të krijuar miqësi të reja dhe për të mësuar vlera të rëndësishme.

Eljona Boce Elmazi, Drejtoreshë

*World Vision Albania*

Unë e njoha këtë fondacion përmes kontributit dhe bashkëpunimit që kemi pasur për të rritur cilësinë e shërbimit ndaj fëmijëve në institucionin tonë.

Falë kontributit të Alo ! Mik, fëmijët tanë pushuan këtë vit tek kampi Eden Park. Aty fëmijët ndërtuan miqësi të reja, zhvilluan veprimtari të ndryshme sportive, artistike dhe shpirtërore, rritën vetëvlerësimin dhe motivimin për sjellje pozitive.

Gjithashtu, kemi hartuar një plan të pasur trajnimesh, për zhvillimin profesional të punonjësve të institucionit tonë në fushën e trajtimit të traumës së fëmijërisë. Bashkëpunimi është shtrirë edhe në fushën e de-institucionalizimit.

Në këtë kohë të shkurtër të drejtimit të këtij institucioni, ndjeva këtë mbështetje të madhe në sfidat që na parashtron sigurimi dhe mbrojtja e jetës së fëmijëve për të cilët ne përkujdesemi. Jam e sigurt që ky bashkëpunim do të vazhdojë dhe jam e lumtur që kam pranë miq të tille, në misionin tim.

Urime për arritjet tuaja të mëdha dhe suksese të mëtejshme të nderuar miq!

Valbona Imeraj, Drejtoreshë

*Shtëpia e Fëmijës Shkollor Zyber Hallulli, Tiranë.*





# UDHËTIMI NË TË ARDHMEN

## Prioriteti i Alo! Mik

gjatë viteve të ardhshme do të jetë:

### KUJDESEMI...

... për fëmijët dhe familjet nëpërmjet ndërhyrjeve

të drejtpërdrejta dhe gjithëpërfshirëse

... Për ata që punojnë me ta (përfshirë stafin tonë) duke i kushtuar vëmendje aspektit shpirtëror, ndërveprimit mes njeri-tjetrit dhe aspektit praktik.

### FUQIZOJMË...

... fëmijët dhe familjet të bëhen agentë të ndryshimeve

në jetën e tyre dhe në komunitetet e tyre

... punonjësit dhe profesionistët e fëmijëve që t'i ofrojnë fëmijëve kujdes jetëndryshues

### MOBILIZOJMË...

... punonjësit dhe profesionistët për të shkuar përtej 'zonës së tyre të rehatisë' dhe për të arritur tek fëmijët

... Kishat dhe familjet t'i përgjigjen thirrjes së Perëndisë për t'u kujdesur për më të pambrojturit

### LIDHIM...

... fëmijët dhe familjet me Kishën lokale

... punonjësit dhe profesionistët të shkëmbejnë dhe punojnë së bashku për të sjellë ndryshime në shkallë të gjerë për fëmijët

... aktorët ungjillorë lokalë që të ndërtojnë Mbretërinë e Zotit me dashuri dhe siguri për fëmijët gjithashtu dhe me institucionet publike për një ndikim më të madh dhe të gjerë

## Ndërhyrjet tona



**QËNDËR KOMUNITARE**  
Shërbime për fëmijët  
dhe familjet në rrezik



**QËNDËR E TRAUMËS & KRIZËS**  
Shërbime & trajnime për traumën  
& krizën



**QËNDËR PËR KAMPE  
DHE KONFERENCA**  
Një vend për përjetime  
shpresëdhënëse



**TRAJNIME DHE RRJETËZIMI**  
Mbështetje për drejtuesit  
e shërbësive të fëmijëve



# FALEMINDERIT!

*"Por unë kam ardhur që të kenë jetë  
e ta kenë me bollëk."*

*Jezusi (Gjoni 10 v 10)*



KONTAKT



[www.alomik.org](http://www.alomik.org)



[info@alomik.org](mailto:info@alomik.org)

+355 69 40 43 184